



**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL IV/2022

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 4 (katërt) për vitin 2022 të Kuvendit të
Komunës së Suharekës**

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 28.04.2022
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyqi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina
Zenelaj
Z.Alban Berisha
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj.Mimoza
Bajraktari
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina
Znj.Saranda
Bajraktari
Z. Driton Maliqaj
Z. Xhevshet Gashi
Z.Edon Sadikaj
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Znj.Festë Kabashi
Z.Herolind Limaj
Znj. Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës

Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi.

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për ndryshim - plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153;**
- 4. Shqyrtimi i projekt - vendimit për emërimin e komisionit për ndarjen e mirënjohjeve për “13 Qershorin”;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-12176;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri-alokimin e mjeteve brenda fondit burimor (38),Grandi Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal: 2022 nga projektet kapitale;**
- 8. Formimi i komisionit për ta përcjell procesin e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit “Hartës Zonale të Komunës së Suharekës” ;**
- 9. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar - mars 2022;**
- 10. Informatë për rastet e përgjithshme të dhunës në familje;**
- 11. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe i njofton të pranishmit se është një kërkesë për një pikë shtesë.Kjo pikë ka të bëjë me komisionin e vlerësimit të pronave.Është rekomandim nga MAPL,ku kërkon që këtij vendimi, në përbërje të këtij komisioni të marrin në shqyrtim edhe 4 parcella.Kjo ka ardh të hënën dhe ne e kemi obligim me fut në rend dite.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë për rend dite.

15 për, 11 kundër,

Miratohet pika shtesë

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

15 për, 11 apstenime

Mirtohet rendi i ditës me pikën shtesë

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - a keni vërejtje në procesverbal?

Urim Suka - përshëndet të pranishmit.Ky procesverbal nga i kaluari ka përmirësim.Nuk është shkru qartë ajo që kemi thënë.Me një rast aty shkrun: drejtori dha përgjigje.Ju kisha lut aty me figuru përgjigjet, e drejtorit ose të Kryetarit.

Liridon Fandaj - përshëndet të pranishmit. Vërejtja ime është që nuk është përfshi ajo çka është diskutuar për stacionin e autobusave. Replikat e mia me kryeshefin nuk janë transmetuar dhe është pre si video, por dhe në procesverbal nuk janë ato pika. Kërkoj të futet në procesverbal ai diskutim.

Kryesuesi - e hedh në votim procesverbalin.

22 për, 3 kundër,

Miratohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - ne në parim kemi qenë që zona Industriale të shfrytëzohet sa ma shumë dhe ajo zonë me u zhvillu dhe me u hap vende të reja të punës. Në kuadër të kësaj ne i japim mbështetje këtij projekt-vendimi. Duhet ta keni parasysh që komisionin e pronave në formën si e keni formuar, për herë tjera, ne ndoshta detyrohemi me pas vendime tjera përshkak se ju keni vendos me formu një komision të njëanshëm.

Festë Kabashi - përshëndet të pranishmit. Pasi ka qenë vendim i pezulluar, a është ligjor ky vendim?

Avni Bytyqi - Përshëndet të pranishmit. Për këtë projekt-vendim është zhvillu një procedurë e konkurimit të hapur mandatin e kalum dhe nga muaji qershor kjo procedurë ka ngel si pasojë e shpalljes së zgjedhjeve lokale. Në ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës thotë që: në momentin kur presidetja e Republikës së Kosovës shpall zgjedhjet, të gjitha procedurat e pronës publike pezullohen deri në inaugurimin e organeve të reja.

Kryesuesi - e hedh në votim.

**10 për, 15 kundër,
Nuk Miratohet**

Urim Suka - nuk e prita një rast të tillë. Keni formu komisione, keni bo raporte, keni bo vlerësimne, keni ardh deri te pika finale dhe sot pe qoni dorën për me pengu ni biznes me zhvillu aktivitetin e vet, tu ja pamundësu investimet në atë zonë dhe tu e pamundësu me hap vende të punës. Kryetar a mundesh me dhan sqarim, çka t'ka shty me i detyru asambleistat e tu me nal ni vendim të tillë?

Kryetari - Asambleja është organi më i lartë se Kryetari. Vendimet i merr Asambleja.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit. Ky projekt-vendim është i komisionit të kalum. Me sa e di unë personi i cili e ka fitu këtë parcellë, në 2016 e ka dhuru me vetëdëshirë sepse ska pas asnjë cent investim. D.m.th komisioni duhet me pas parasysh ose me nxjerr një akt nënligjor për ata që nuk kanë investim, me i penalizu në një formë. Në këtë formë kemi marrë vendim me votu kundër.

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për ndryshim - plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Qëndrim Elshani - në emë të LVV-së propozoj Laureta Tafaj.

Kryesuesi - e hedh në votim, që në vend të Festë Kabashit të jetë në komisionin për ndarjen dhe definimin e banesa dhe lokaleve afariste, Laureta Tafaj.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt - vendimit për emërimin e komisionit për ndarjen e mirënjohjeve për "13 Qershorin";

Kryesuesi - e laboron këtë pikë dhe thotë se ky komisioni mandatin do ta ketë aq sa është mandate i anëtarëve të Kuvendit. Ky komision do ti ketë 7 anëtar, dy do të jenë nga shoqatat e dala nga lufta dhe janë

të propozuar Destan Zekolli dhe Adem Bytyqi. Neve na duhet ti kemi edhe 5 anëtar dhe unë si kryesues shkoj me automatizëm. Kërkoj propozimet.

Doruntina Zenelaj - nga grupi i LDK-së propozojmë Bulëza Kuçin.

Dardan Berisha - PDK propozon Bajram Bashën.

Qëndrim Elshani - LVV propozon Festë Kabashin.

Nga NISMA propozohet Jehona Rrafshi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4 me këtë përbërje të komisionit: Bexhet Kuçi, Bulëza Kuçi, Bajram Basha, Festë Kabashi, Jehona Rrafshi, Destan Zekolli dhe Adem Bytyqi.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë që ky komision do të jetë prej 7 anëtarëve ku 4 vijnë nga Kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe 1 vje nga secili lokacion ku zgjedhet këshilli i fshatit. Kryesuesi kërkon propozimet.

Driton Maliqaj - në emër të subjektit të AAK-së propozoj Saranda Bajraktari.

Flamur Bytyqi - në emër të grupit të LDK-së propozoj Alban Berisha.

Mevludë Kabashi - PDK propozon Dardan Berisha.

Qëndrim Elshani - nga LVV propozojmë Liridon Fandaj.

Kryesuesi - nga ekzekutivi është Visar Kuçi dhe Kimete Bajraktari. Na duhet një femër për shkak të barazisë gjinore në këtë komision dhe kërkoj nga VV-ja ose LDK që të reflektojnë.

Qëndrim Elshani - deri tash patëm dy propozime femra, ku propozum Festën dhe Lauretën. Besoj që është e udhës që subjektet tjera me propozu.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5 me këtë përbërje të komisionit: Saranda Bajraktari, Alban Berisha, Dardan Berisha, Liridon Fandaj dhe nga ekzekutivi do të jetë Kimete Bajraktari, Albulena Kokollari dhe një përfaqësues shkon gjithmonë prej lokacionit se ku zgjedhet këshilli i atij lokacioni.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-12176;

Kryesuesi - kemi të bëjmë me vendimin për shujtje të administratës, e cila është kthy negative nga Ministria e Financave dhe kërkohet të shfuqizohet. Ne e kemi prurë për me shfuqizu deri në momentin kur e gjejmë mundësinë mi bo këto pagesa.

Dardan Berisha - kemi provu në 2017 dhe 2021 dhe e provum edhe tani. A do të mbetet kjo apo do të vazhdohet tutje për pagesën e shujtjes së punëtorëve të administratës?

Kryesuesi - drejtimi ka qenë i duhur, por përgjigja ka qenë që nga ky kod nuk mund të bëhet pagesa. Zyrtari ligjor financiar ka kërkuar sqarime edhe me shkrim. Ka kërkuar edhe udhëzime se prej cilit kod mund të bëhen pagesat. Nuk kanë kthy përgjigje, dhe ne e kemi obligim me prurë, me diskutu dhe me shfuqizu.

Urim Suka - lidhur me këtë projekt-vendim që keni sjell mund të themi që ky projekt-vendim tregon joseriozitetin tuaj pothuaj në secilin vendim që ju merrni. Unë personalisht në KPF dhe në Asamble kam kërku të na spjegoni për mënyrën e implementimit të këtij projekt-vendimi, e të cilin ju nuk e sqaruat kurrë. Madje ndër të tjera kam thënë: ky projekt-vendim në formën se si ju po e parashtroni është i destinuar të dështojë. Këtë projekt-vendim jeni të detyruar ta shfuqizoni për vet faktin, pasi që Ministria e Financave e ka cilësuar si të kundërligjshëm. Kur kësaj ia shtojmë edhe faktin e mos aprovimit të disa projekteve të miratuara në buxhetin e vitit 2022, atëherë shihet qartë keqplanifikimi i qeverisjes tuaj për të cilën ne jemi duke folur në vazhdimësi. Ne si LDK kërkojmë nga kjo qeverisje që të shfrytëzojë të gjitha mundësitë që ka për ti gjetur zgjidhje kësaj që është shumë të rëndësishme për punëtorët e administratës komunale dhe si rezultat i kësaj, ne do ta apstenojmë këtë vendim deri kur ju të gjeni një zgjidhje tjetër.

Shefket Kolgeci - përshëndet të pranishmit.Këtë projekt-vendim që e keni prurë,unë e shoh si paaftësi e qeverisë,paaftësi e Kryetarit.Kjo është një temë që është dasht me u kry,por neglizhenca e qeverisë e ka bo mos me u kry.Ka mundësi të gjinden forma se si me realizu këtë projekt-vendim sepse është e nevojshme dhe e domosdoshme për punëtorët e Kuvendit Komunal.Është dashtë zyrtari i financave me u konsultu paraprakisht me ministrinë dhe me gjet një formë për me miratu.Unë e kam propozuar edhe me 3.5 euro.Andaj angazhohuni dhe gjeni formën e duhur.

Kryesuesi - sa për sqarim,qeveria i ka siguruar mjetet.

Driton Maliqaj - përshëndet të pranishmit.Ne sot ballafaqohemi me vendime të ndryshme të ministrive të linjës.Rastin konkret e patëm edhe për një vendim të pikës shtesë të cilën e sollën sot Komuna,dhe e shohim që Ministria e njejtë vendimet i merr të ndryshme.Në rastin konkret edhe këtu kemi të bëjmë me vendime të ndryshme.Vullneti i ekzekutivit dhe Asamblesë ka qenë që këto shujta të ndahen për punëtorë dhe të simulohen sado pak sepse pagat e tyre janë tejet të ulta. Të njejtin vendim kemi në Komuna tjera të cilat janë aprovu me këto kode buxhetore,përshkak se kodet buxhetore janë dy.Nuk kemi mundësi tjetër pos në dreka zyrtare nga mallra dhe shërbime.

Liridon Fandaj - nëse ky e gjen një vendim që sivjet u miratu dikun tjetër,atëherë ne s'kemi nevojë me shfuqizu.Mujm me bo kërkesë tjetër.Por ky mun me than për vitet tjera që janë bo vendime me telefona. Por sivjet nuk shkon me telefon.

Driton Maliqaj - nuk e ceka asnjë prej zyrtarëve,me telefona ose internet,por e thash Ministria.

Liridon Fandaj - nëse e gjen një vendim tjetër që u miratu ashtu,atëherë ne nuk e shfuqizojmë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

16 për, 3 kundë, 9 apstenime
Miratohet pika 6.

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri-alokimin e mjeteve brenda fondit burimor (38),Grandi Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal: 2022 nga projektet kapitale;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - ky projekt-vendim vjen pasi që Qeveria e Kosovës nuk i ka miratuar disa nga projektet që ju keni propozu në këtë buxhet.Kjo ka ndodh si rezultat i keqplanifikimit që ju keni bërë gjatë përpilimit të buxhetit për vitin 2022.Gjatë kohës kur është shqyrtu ky projekt-buxhet,ne kemi qenë kundër dhe kemi dhënë vërejtjet tona lidhur me buxhetin që ju keni propozu,ku ndër të tjera kemi thënë që ky buxhet është i keqplanifikuar dhe nuk mbron interesat e qytetarit.Sot rezulton që ne kemi pas të drejtë. Në mbledhjen e fundit të Asamblesë,ju keni miratu strategjinë për zhvillimin ekonomik lokal.Në këtë strategji që ju keni hartu e miratu muajin e kaluar, janë parapa një numër i madh i projekteve në bujqësi.Ndërsa sot keni sjell këtë projekt-vendim i cili 470 mijë euro ia merr bujqësisë.A mund t'më tregoni se ku e bazoni këtë projekt-vendim?Për të pas kuptim ky projekt-vendim,ju ose duhet ta shfuqizoni vendimin e marrë muajin e kaluar për strategjinë, ose të mos e miratoni këtë vendim sot.Lidhur me këtë,ne mendojmë ,që të heqësh nga bujqësia një shumë kaq të madhe të planifikuar për vitin 2022,është të lësh bujkun Therandas në mëshirë të fatit.Madje ju keni premtuar që buxheti për bujqësi do të jetë 1 milion për një vit.Ky projekt-vendim që ju e keni sjell është në vazhden e asaj që ju po punoni,pa strategji, në dëm të bujqëve tanë dhe në këtë rast ne nuk e mbështesim.

Selman Kolgeci - përshëndet të pranishmit.Sa i përket kësaj pike,fillimisht kërkoj sqarime nga drejtori i bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural,se cilat projekte i janë hequr listës së investimeve.Sepse veprime të tilla trgojnë nivelin e seriozitetit dhe qëllimin e ulët që ka qeverisja lokale në raport me bujqit e vendit tonë.Pra ju, në kulmin e rritjes së çmimeve,përfshirë edhe rritjen e çmimeve të prodhimeve bujqësore, keni vendosur të mos tregoheni vigjilent e të mos keni projekte serioze për investime në bujqësi.Për këtë arsye edhe ju kam refuzu.Andaj është e papranueshme që si pasojë e paaftësisë tuaj,të mos kalojnë projektet e bujqësisë.Çka do ti thoni bujkut sot?Si do ta arsyetoni paaftësinë tuaj para bujkut? A do ta fajsoni edhe në këtë pikë opozitën për mosbashkëpunim?E kemi ngritur si shqetësim kur është miratuar buxheti,se buxheti i propozuar i Kuvendit që ka marrë shumicën e votave,nuk është buxhet për qytetarët por është për larjen e hesapeve elektorale.Ju jeni duke i marrë mjetet bujkut dhe po investoni në ndërtimin e kolektorit në rrugën“Skënderbeu“.A do ta ketë fatin e njejtë edhe ky Kolektor si Unaza e Qytetit,si Shëpia e Kulturës,rruga Mushtisht-Delloc e shumë projekte tjera të nisura e të papërfunduara me vite të

tëra.Si nismë ndërtimi i Kolektorit është mirë dhe është në shërbim të qytetarit,por duhet të dihet se a ka projekt ky investim,sa është gjatësia e tij,sa ka qenë gjatësia e tij me projekt-buxhetin 2022-2025,ku fillon,ku përfundon,a është paraparë që ly projekt-vendim të përfshijë edhe rrugën „Hajdin Berisha“,në cilën pikë shkarkohet ky kolektor,sa është sasia e ujit që nxjerr ky kolektor dhe a paraqet rrezik shtesë përqendrimi i sasisë së madhe të ujit në fshatrat që janë të ekspozuara nga vërshimet.Pra, nëse ky investim dhe kjo përlllogaritje e mjeteve në emër të këtij projekti po bëhen pa projekt të mirëfillt,është punë nën çdo standart profesional,etik e nën çdo moral politik.

Ardian Kotorri - përshëndet të pranishmit.Ajo për të cilën gjendemi në këtë situatë për këtë pikë të rendit të ditës,është shqetësim i qeverisjes komunale,i Kryetarit,i imi si drejtor por edhe i gjithë qytetarëve të Therandës.Projektet të cilat i ka vendos në rezervë Ministria e Financave,janë projekte të cilat të gjitha Komunave të Kosovës ia kanë vendos në rezervë .Ia kanë vendos në rezervë Rahovecit, Prizrenit, Malishevës,Ferizajit.Jam në kontakt me të gjitha drejtoritë komunale të bujqësisë në nivel të Kosovës. Arsyet pse i kanë vendos në rezerva është për shkak se, ata investimin në sera,investimin në shtalla,investimin në mekanizmin bujqësor pe konsiderojnë jo si investim kapital por si subvencion.Nuk është viti i parë,edhe vitin e kaluar edhe para dy e tri viteve ministria ka bo vërejtje në këtë drejtim,por në momtet e fundit i ka kalu këto projekte.Ku kemi pas mundësi me i planifiku këto projekte?Le t'ma thotë një projekt dikush që kemi mujt me planifiku dhe prap nuk na kish vendos në rezervë.Për atë ,edhe jemi të shqetësuar për arsye se nuk kemi mundësi me projekte kapitale mi përkrah fermerët në sera,shtalla,në mekanizëm bujqësor.Vërtet planifikimi ka qenë 1 milion euro për këtë drejtori,ka qenë vullneti i Kryetarit Vitin e ardhshëm do ti shqyrtojmë mundësitë në konsultim edhe me Komunat tjera,do ta gjejmë një formë,një model për shkak se jemi në hall të madh.

Selman Kolgeci - sapo e pranove që jeni të paafhtë për këtë punë.Hajdeni te ekspertat e LDK-së,ju ofrojmë projekte sa të doni.

Ardian Kotorri - nuk është hek krejt buxheti.Partia politike në vitin 2009 me 27 mijë euro e ka lan buxhetin e bujqësisë,ndërsa një parti tjetër që po qeveris sot,e ka planifiku një buxhet 1 milion euro.Kemi 120 mijë euro më shumë të gjitha drejtoritë për subvencione.

Selman Kolgeci - qeveria më nuk i mbulon damet në bujqësi,a po?A po mendon që nuk kish kalu projekti për sigurimin e produkteve bujqësore,p.sh. rrushin.Lexoje programin e LDK-së,i gjen krejt qeto.

Ardian Kotorri - programin e LDK-së kanë pas mundësi me lexu të gjithë qytetarët,e kanë lexu por nuk ja ka mush mendjen.Për fondin që the,ne i kemi pas të planifikume 25 mijë euro.

Urim Suka - e kanë vendos në rezrvë projektin për shkak të keqplanifikimit.Këto mjete ministria nuk t'ka than qoji te shërbimet publike apo dikun tjetër.Ke mujt prap mi lan te bujqësia ,por ju skeni projekte për mi lan te bujqësia.Kur skeni projekte pse i premtoni 1 milion euro.Në fund ,buxheti që ju ka met,ju ka met veq për rroga edhe për rrugë fushore.

Qëndrim Elshani - ne si grup i asambleistëve të LVV-së do ta përkrahim këtë rialokim të mjeteve,po sikur këto mjete të shfrytëzoheshin për sektorin e bujqësisë dhe do të destinoheshin në projekte që do ti ndihmonin bujqëve në një sektor ku ata kanë nevojë. Ndërtimi dhe ngritja e serave,Fondi emergjent për bujqësi,Rregullimi dhe ndërtimi i shtallave për bagëti,Ngritja e kapaciteteve të mekanizmit bujqësor për fermerë në komunën e Suharekës.Tash Ministria e Bujqësisë ka planifiku subvencione në vlerën prej 50 milion euro,e grande në vlerë 26 milion euro për këto kategori.Mirëpo nuk do të thotë që ne si Komunë nuk kemi sektorë tjerë ku mujna me i rialoku.Edhe pse bujqit janë duke u përkrahur nga kjo qeveri si asnjëherë më parë,është gabim të mendojmë që shuma prej 410 mijë euro mund ti dërgohet një Kolektori, dhe rreth 60 mijë euro për projektin me bashkëfinancim para bujqëve të kategorive që nuk mund të përfitojnë nga drejtoria e bujqësisë.Ky rialokim i mjeteve në vlerë prej 410 mijë eurove nga bujqësia dhe 10 mijë euro nga inspeksioni në projektin „Ndërtimi dhe rregullimi i kolektorit në rrugën Skënderbeu“,te projektet kapitale për vitin 2022 është planifiku të jetë 182500 euro,por për vitin 2023 dhe 2024 nuk ka mjete të planifikume për këtë projekt.Cila është logjika që duhet ti rialokojmë mjete në vlerë 420 milion euro me një projekt që na kushton 180 mijë euro.Edhe kolektori është i nevojshëm,por duhet me gjet forma tjera dhe jo me dëmtu bujqësinë.Sa i përket mjeteve të planifikume për infrastrukturën rrugore në Suharekë në vlerë 145 mijë euro,do të ishte mirë që të rialokoheshin projektet kapitale që janë të planifikume në vitet 2023-2024,e jo të dërgohen projekte me bashkëfinancim.

Kushtrim Kuçi - i drejtohet drejtorit të bujqësisë dhe thotë: përmende 2009-tën.Në vitin 2009 buxheti ka qenë shumë i vogël, dhe drejtoria e bujqësisë, ato pare ka mujt mi nda veq për rroga.Janë 13 vite

diferencë,buxheti është shumfishu dhe rezultati po del si në vitin 2009 me buxhet të vogël.Ky është arsyetim banal.

Kryetari - është e vërtetë që kam premtu 1 milion euro,dhe e kam bo 1 milion euro.Ne që jemi në pushtet zbatojmë ligjet dhe rregulloret që dalin nga parlamenti i Republikës së Kosovës,dhe jemi të interesum mi zbatu.Ata që kanë qenë asambleista e mbajnë mend që çdo herë kemi pas ndryshime nga qeveria e republikës së Kosovës.Asnjëherë buxheti ska qenë ma i madh.Krejt investimet kapitale bëhen në bazë të nr. të banorëve Pyetja ishte ku fillon kolektori.Kolektori fillon prej shtratit të lumit,del te Unaza e parë ose te rrethrotullimi që vje prej autostradës,ka me ardh deri te varrezat e qytetit.I kemi planifiku 180 mijë sepse aq kemi pas mundësi,kemi dasht me shku faza faza.165 mijë kerre në javë kalojnë në atë rrugë,dhe ajo është interes i qytetit,spse aty lidhet Samadraxha,Studenqani,Rahoveci,Mamusha,dhe qëllimi është me shku në interes të të gjithëve.Kemi me pas shumë shpejt 520 mijë euro për grand të performancës,kemi mi marrë 320 mijë euro për mbikalimin prej Ministrisë.Është e drejtë e juaja me kritiku dhe duhet me kritiku.Doktorr,në moment që e gjen metodën për pagesë të shujtave,munesh me pru propozimin dhe unë të garantoj që do ti kesh votat e Asamblesë.

Shefket Kolgeci - ju, Kryetari,qeveria merrni rrogë për këtë punë dhe ju duhet me gjet metodën dhe jo asambleisti.Unë menedoj që ka mundësi me gjet forma,por mos puna juaj e ka pru dej te shfuqizimi.Propozoj që për Bajram tu ndihmoh punëtorëve të administratës.

Kryetari - këto nuk paguhen nga pagat dhe medijtjet,kupto.

Urim Suka - vendimi i ministrisë për me ti vednos në fondin rezervë ato mjete,është për shkak se ju nuk i keni lexu udhëzimet administartive që ata i kanë lexu.Tendenca e kësaj paaftësie që mjtete e buxhetit të bujqësisë pi qon te kolektori i rrugës Skënderbeu,tendenca me manipulu e me arsyetu është për keqardhje.Ne si LDK e mbështesim projektin e Kolektorit ,por me pas dasht,ato mjete mi qu te kolektori i kish planifiku me fillim.Uroj ta ndryshoni këtë qasje.

Qëndrim Elshani - kërkoj prej Kryetarit që mos me nxerr prej kontekstit atë që e thash.Ai tregoi rëndësinë e kolektorit.Unë po e citoj veten çka thashë.Thashë:kolektori është shumë i rëndësishëm,por duhet me gjet forma tjera për me bo,dhe jo me marrë pare nga bujqësia.

Flamur Bytyqi - unë fillimisht pata fol për punën e shujtave,dhe me sa kujtoj Kryetari veq e ka majt një takim me sindikatën e punëtorëve të administratës,dhe i ka premtu që kjo punë ka mu kry.Unë qysh në fillim ju kam tregu që është e paligjshme,për shkak që nuk e kanë një kontratë kolektive.Nëse s'gaboje është komuna e Skënderajit që ia pagun.U dash me kqyr zyrtari financiar,edhe pse insistojke që është në rregull dhe ka mu munu me gjet formën.

Dardan Berisha - është e vërtetë që ka qenë propozim i PDK,jo veq ky por edhe nja 20 propozime tjera.PDK në 2017-2021 e ka gjet atë rrugë përmes ideve e propozimeve dhe jo përmes letërsisë.

Liridon Fandaj - nëse në një projekt 182 mijë euro për Kolektor i qon edhe 460 mijë euro,a është e sigurtë që ministria ka me miratu?

Kryesuesi - nëse ju nuk intervenoni,e miraton ndoshta.

Liridon Fandaj - ni kolektor në shesh u bo për ni biznes,edhe ky është tu shku për ni biznes.

Kryesuesi - ky është për qytetarë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

**16 për, 11 kundër
Miratohet pika 7**

Pika 8. Formimi i komisionit për ta përcjell procesin e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit “Hartës Zonale të Komunës së Suharekës” ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe ia jep fjalën Sanie Kuçi-Rexhepaj.

Sanie Kuçi Rexhepaj - përshëndet të pranishmit.Në mbledhjen e kalume u diskutu dhe u miratu Shqyrtimi publik i Hartave Zonale,dhe unë pata një propozim,që me formu një ekip i cili ka me përcjell shqyrtimin publik të Hartave Zonale.Ky propozim erdhi për arsye se dokumenti Hartat Zonale është dokumenti ma i rëndësishëm, që shpresojmë ka me u miratu.Duke e pare mosinformimin e saktë të secilit anëtar të Kuvendit Komunal rreth këtij procesi,unë propozova që me u formu një ekip me nga një përfaqësues nga secili subjekt politikë,në mënyrë që me përcjell këtë proces dhe me pas informatat më të sakta.Falemnderon anëtarët e KPF të cilët e kanë votu që kjo pikë me dal në Asamble,dhe ftoj grupet

parlamentare ti japin emrat e anëtarëve. Kërkoj të di nga zyrtari ligjor ,te projekt-vendimi,mos duhet me cek edhe kush kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.Në emër të AAK-së propozoj Afërdita Mamaj.

Avni Bytyqi - realisht zbatimin e këtij vendimi e bën ky komision.

Festë Kabashi - edhe pse ky komision nuk është vendim-marrës,unë kërkoj që kërkesat e qytetarëve të merren parasysh.Nga subjekti ynë politikë propozojmë Liridon Fandaj.

Shefket Kolgeci - LDK propozon Kushtrim Kuçin.

Mevlude Kabashi - PDK propozon Dardan Berisha.

Kryesuesi - kemi 6 anëtar dhe na duhen edhe dy emra femra.

Dardan Berisha - në këtë rast unë tërhiqem dhe propozoj Sheqerije Zyrapi.

Kryesuesi - nga NISMA propozohet Jehona Rrafshi,dhe nga Iniciativa Qytetare propozohet Herolind Limaj.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 8 me këtë përbërje të komisionit:Afërdita Mamaj,Kushtrim Kuçi,Sheqerije Zyrapi,Liridon Fandaj,Jehona Rrafshi dhe Herolind Limaj.

Unanimisht Miratohet

Pika 9. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar - mars 2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - kur jemi te raporti i buxhetit të komunës së Suharekës për periudhë janar-mars 2022,më lejoni që fajlën time ta filloj me 51% e Kryetarit Muharremaj, për faktin se në tri mbledhjet e fundit të Kuvendit thirret me 17 tetorin dhe rezultatin e tij.Ndërsa në anën tjetër ekzekutimin e buxhetit për investime kapitale për këta tre muaj e ka zero.Qytetarët me 17 tetor juve ju kanë dhënë pushtetin ndërsa neve opozitën.Prandaj ne po angazhohemi fuqishëm për të përmbushur rolin që qytetarët me 17 tetor na kanë dhënë.17 tetori nuk është rezultat i qeverisjes tuaj të mire,por rezultat i propagandas tuaj masive permes portaleve të blera.Por kjo nuk do ndodh më, sepse angazhimi jonë është i përditshëm.Për ta vërtetu këtë fakt,mjafton fakti që për një kohë të shkurtë kanë dhënë dorëheqje dy Kryetar të nëndegëve tuaja,përkatësisht me pretekstin që ju i keni mashtruar.Para jush paraqes kontratën e ndërtimit të rrugëve Hafir Gashi,25 Gushti dhe Osman Dalipi në Javor.Kjo kontratë është thjesht një letër sepse rrugët nuk janë shtruar.Pyetja ime është: A e din 51 % e qytetarëve që ju kanë votu,që ju keni hap një tender,keni shpall fitues,keni hartu një kontratë dhe rrugët nuk i keni shtruar.Përgjigja është se nuk e din,por e vërteta është se ata nga sot do ta din. Andaj,ju ftoj të reflektoni e të punoni në interes të gjithë qytetarëve,sepse unë këtu do të jem për secilën kontratë e për secilin vendim ,e do të ushtroj rolin tim si opozitë,dhe ju siguroj që propaganda juaj nuk do të ecën më.Fton Kryeatrin që të arsyetoj kontratën e tri rrugëve në fshatin Javor.

Selman Kolgeci - sa i përket planit të ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar-mars 2022,është alarmante vlera të cilën e ka paguar Komuna jonë për vendim t'grykatave.Janë 163568 euro të cilat komuna i ka paguar për vendime gjyqësore,e prej tyre 94 % janë nga drejtorja e arsimit.E dim që kjo vlerë vje nga Drejtorja e Arsimit si pasojë e mos-zbatimit të kontratës kolektive,dhe këtë qështje e kemi ngrit edhe seancën e kaluar.Kërkoj sqarim nga Drejtori i Arsimit të na precizojë saktë e drejtë se sa nga këto mjete kanë shkuar tek mësimitshënësit e sa në shpenzime gjyqësore?Ju në këtë mënyrë,me këto metoda,përpos që po dëmtoni buxhetin e Komunës,po tregoni edhe paaftësinë tuaj për t'qeverisur.

Remzi Bajselmani - ky është një problem i madh në Kosovë,në të gjitha Komunat.Nuk ka formë dhe kod buxhetor që të paguher shujta,ndërsa pagat jubilarë dhe pagat përcjellëse janë në sistem dhe paguhen.

Selman Kolgeci - a ka mundësi, seancën tjetër me na nxjerr saktë,sa ja keni pagu mësimitshënësave dhe sa grykatave.Avokati i Komunës po i kundërshton landët.Pe dini që ka me fitu dhe po bon prapsim,pi shkakton shpenzime shtesë Komunës.

Remzi Bajselmani - i kemi të dhënat por janë procedura që i zbaton Gjykat.Paraprakisht i bëjmë prapsimet dhe i sqarojmë për çka nuk zbatohet kjo kontratë,ndërsa kur kalon në gjykatë ne nuk merremi më.

Selman Kolgeci - unë kam pa prapsime që ka bo Komuna e Suharekës kundrejt vendimeve të Gjykatë,jo një po shumë.A ka mundësi me ditë sa jemi tu pagu për gjykatë dhe sa për mësuesat?

Remzi Bajselmani - ne shifrat i bim,por vendimet e gjykatës nuk i prapsojmë.

Festë Kabashi - te arsimit fillor,sa i përket furnizimit me dru,fondi ka qenë 20.906,60.Kam raste në disa shkolla që kanë pas mungesë të druve.A është bo shpërndarja e të hollave ose drunjëve në mënyrë të barabartë në secilën shkollë,apo vje si kërkesë e shkollës.

Remzi Bajselmani - po,është një kontratë dy vjeqare qe e ka marrë operatori dhe zbatohen sipas kërkesave që e bëjnë shkollat.

Driton Maliqaj - Kisha dasht me ta spjegu Urim që Aleanca është që dy vite në proces të zgjedhjeve të mbrendshme,dhe nga momenti i shpalljeve të përgjithshme të Aleancës,të gjithë anëtarët nuk kanë mandate dhe merren me procesin e zgjedhjeve të mbrendshme.Pra secili e ka vullnetin me dhanë dorëheqje apo jo,mirëpo jo duke u thirrur në emër të kryetarit të nëndegës.

Urim Suka - Dritoni shpesh munohet faktet me i pshjtjell,me i paketu dhe të gjithë e din pse kanë dhënë dorëheqje.Kryetar,qetu e kam një kontratë për rregullimin e rrugëve Hafir Gashi,25 Gushti,Osman Dalipi në Javor,ke bo kontratë rrugët s'i ke shtru.Qu arsyetoje.

Kryetari - Kryetari nuk nënshkrun kontrata,lexoje mirë.Marrëveshja me dy fshatave Javor-Luzhnicë ,me kërkesën e tyre është bo rruga për shkak të fëmijëve që shkojnë në shkollë,në Luzhnicë dhe Javor.

Urim Suka - e para:po hek dorë taktikisht nga përgjegjësia jote.e dyta:me bo marrëveshje dy fshatrat se cilën rrugë me shtru,është shkelja tjetër,dhe e treat:të ftoj tash të shkojmë në Javor dhe Luzhnicë,dhe të shikojmë gjendjen e rrugës sepse është për keqardhje.

Kryetari - dje e kum pa.Ofanziva për punë në komunën e Suharekës fillon mas Bajramait,mbi 10 milion euro për këtë vit investime kapitale.

Pkika 10.Informatë për rastet e përgjithshme të dhunës në familje;

Kryesuesi - për këtë pikë ia jap fjalën nënkryetares së Komunës znj. Mihrije Suka.

Nënkryetarja - përshëndet të pranishmit,dhe informon të pranishmit rreth kësaj pike.Dhuna,në familje kudo që ndodh është shkelje e të drejtave të njeriut e që më së shumti i prek gratë dhe vajzat duke mos prejashuar të gjitha shtresat e shoqërisë pa dallim.Përkundër të gjitha të arriturave,krijimin e mekanizmeve,përsëri dhuna është evidente.Ne si grup i grave,përfshirë zyrën për barazi gjinore, Asambleistet e të gjitha partive politike,Drejtoreshat e Drejtorive Komunale dhe me mbështetjen e Kryetarit të Komunës z. Bali Muharremaj kemi ngritur zërin,kemi marrë iniciativa për përmirësimin edhe avansimin e pozitës së gruas,e në veqanti kundër dhunës në familje, permes organizimeve të fushatave të ndryshme,marshimeve në rrugë,tryezave të diskutimeve,shpërndarjes së fletushkave,ligjeratave vetëdijësuese në shkolla.Bashkëpunimi i këtij grupi funksionon duke mos u shkëputur asnjëherë nga hallkat relevante të institucioneve të profesionalizuara për trajtimin e rasteve të dhunës në familje siq është policia,QKMF,QPS,Zyra për barazi gjinore,strehimorja”Shtëpia e sigurt në Prizren”si dhe” Strehimorja për gra dhe fëmijë në Gjakovë”.Bashkëpunime të tjera nga institucione joqeveritare,OJQ-të vendore, organizata të huaja siq është OSBE,të cilat na mbështesin në oragnizimin e tryezave dhe diskutimeve me temë:pozita e gruas,dhuna në failje dhe buxhetimi gjinor.UENVOMEN një mbështetje për krijimin e mekanizmit të dhunës në familje,i cili mekanizëm funksionon.Aktivitete të cilat janë zhvilluar gjatë viti 2021 së bashku me zyrën për barazi gjinore dhe ne bashkëpunim me gratë asambleiste në fushatën “16 ditë Aktivizëm kundër dhunës në familje” ,ku kemi oraganizuar shumë fushata vetëdijësuese.

Mekanizmi kundër dhunës në familje mban katër takime në vit,ku diskutohen tema,jepen rekomandime nga ky mekanizëm.Nga rekomandimet e mekanizmit është formuar edhe fondi emergjent për rastet e dhunës në familje.Vendimet e marra nga këto rekomandime janë: Fondi emergjent në vlerë 1 mijë euro,mbështetja e strehimores në vlerë 2200 euro,Bonus banimi,ku përfitues janë 7 gra vetushqyese, zyra për shërbime juridike falas,Subvenciopnimi i rasteve të dhunës në familjet nga ana e zyrës së kryetarit si për raste të tjera.Raportimet e rasteve të dhunës në familjet nga stacioni policor për vitin 2021 gjithsej janë 76 raste.Rastet janë në rritje krahasuar me vitin 2019 ku kanë qenë 48 raste.Në vitin 2020 është rritë numri në 51 raste dhe deri në prill të 2022 janë 22 raste.Rastet me ndalim janë 44 raste,viktima femra janë 64 raste,viktima meshkuj 3 raste,viktima të mitur 9 raste,të dyshuar meshkuj për shkaktim të dhunës janë 84 raste dhe femra 3 raste.Sa i përket raportit nga QPS të rasteve të dhunës në familje për vitin 2021, gjithsej në QPS janë që kanë dhanë shërbime social, janë 33 raste.Për rastet e dhunës në familjet me kërkesë të viktimave të dhunës dhe mbrojtësit të viktimave,gjykata ka lëshuar 10 vendime për

urdhëmbrojtje,ndërsa për vitin 2022 në tre mujorin e pare QPS është angazhuar në 12 raste të dhunës në familje,kryesisht dhunë ndaj femrave.Nga shëndetësia kemi trajtime të rasteve në vitin 2021 gjithsej 35 shërbime,në tre mujorin e parë për vitin 2022 janë 6 raste.

Elmaze Bytyqi - përshëndet të pranishmit.Dhuna konsiderohet si një plagë e vjetër e shoqërisë dhe njëra prej formave më të përhapura në botë.Dhuna nuk është trimëri,ajo është pjesë e ligështisë.Dhuna triumfon vetëm atëherë kur ne heshtim.Është bërë mëse normale të dëgjijmë çdo ditë nëpër lajme kronikën e zezë.Megjithëatë mendoni pak çaste se sa e tmerrshme dhe e papranueshme është kur akte të tilla kanë të bëjnë me jetërat e më të dashurve tanë.Siç duket kjo dukuri po përcillet brez pas brezi.Ne si institucione nuk kemi bërë mjaftueshëm për parandalimin e kësaj dukurie.Andaj unë si asambleiste kërkoj që të mbahen orë edukuese në shkollat fillore dhe të mesme ,që ti vetëdisojmë brezin e ardhëm në frymën e barazisë gjinore.Propozoj që të themelohet edhe një komision,që të merret me pasojat dhe arsyen e kësaj dukurie,dhe të gjitha këto të raportohen në Asamblenë Komunale.Të hartohet një plan për parandalimin dhe vetëdijësimin e personave që përdorin dhunë dhe atyre që janë viktima.Të gjithë ne duhet të kemi një rol të rëndësishëm në luftimin e kësaj dukurie.

Urim Suka - duke mbështetur atë që tha parafolësja,unë lidhem me raportin që kemi marrë nga stacioni policor në Suharekë,dhe duke e bo një krahasim prej viteve 2019-2020-2021,rezulton që rastet e dhunës në familjet janë në rritje.Cilat janë aktivitetet që ju si qeverisje në parandalim ndërmerrni dhe çfarë mbështetje ju ofrohet kur këto raste paraqiten.

Nënkryetarja - përgjigjen e dhashë në raport.Të gjitha aktivitetet për dhunën në familje janë në raport. Ka mbështetje për rastet e dhunës në familjet. Thashë që është formu edhe fondi emergjent në vlerë prej një mijë eurove.Nënkryetarja jep sqarime rreth fondit emërgjent.

Festë Kabashi - kam kërkesë për grupin e grave asambleiste,që të jemi më aktive në këto tema të ndryshme,sepse kemi vullnetin e mire,kemi,mundësi me kontribu në forma të ndryshme ,jo me shfrytëzu,me u taku vetëm në ratet p.sh dtën e 8 Marsit.

Pika 11.Shtesë - Formimi i komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e 11 shtesë.

14 për, 11 kundër, Miratohet

Pika 12. Pyetje dhe përgjigje;

Bulëza Kuçi - kërkoj sqarime nga drejtori i DKA-së.Kryetari ka premtuar një sallë sportive në shkollën fillore”Destan Bajraktari”. Këto ditë edhe është tentuar të fillojnë punimet aty,mirëpo disa qytetarë pengojnë punimet.Ku çëndron problemi?Pse japin premtime të kota kur ka kontekste pronësore,pse mashtrohen qytetarët,pse gënjejnë nxënësit kur paraprakisht është dashtë të sigurohet lokacioni.

Kryetari - paret janë,ministria e ka zgjedh kontraktorin,leja e ndërtimit është dhënë dhe presim me fillu punimet.Në fletë të procedurës është prone komunale,edhe pse qytetarët pretendojnë,është qështje e tyre me pretendu.Për derisa nuk kanë ni vendim të plotëfuqishëm,ne do të vazhdojmë punën.

Mevlude Kabashi - kam kërkesë nga qytetarët e Suharekës për rrugën “Xhavit Sylja”,e cila është e dëmtuar dhe banorët e kësaj rruge kërkojnë rregullimin e kësaj rruge.

Kryetari - është e parapame me sanimin e rrugëve,dhe në moment që fillon projekti ,dhe jo veq rruga Xhavit Sylja por edhe shumë rrugë nëpër fshatra kanë me u meremetu.

Dorentinë Zenelaj - pyetje për drejtorin e Arsimit: në fshatin Savrovë është ndërtuar terreni sportive në oborrin e shkollës për nxënës dhe të rinjë që në vitin 2015.Pasi mësimi zhvillohet paradite,të rinjët terrenin sportive e kanë shfrytëzuar pasdite për aktivitete e tyre.Para 10 dite, disa të rinjë janë ankuar te unë se me urdhër të drejtorit të shkollës janë larguar koshat e basketbollit dhe është bërë e pamundshme që të rinjët ti shfrytëzojnë për aktivitetet e tyre.Pyetja është:A jeni në dijeni për një gjë të tillë,dhe nëse po,cila është arsyeja që të rinjëve u mohohet kjo e drejtë,dhe nëse largimi i tyre është bërë pa njohurinë tuaj,a do të merrni masa në kthimin e tyre sa ma shpejtë?

Kryetari - jo vetëm terrenet sportive nëpër shkolla,por edhe sallat sportive nëpër fshatra,e kanë një vendim drejtorat e shkollave që qytetarët ti shfrytëzojnë mas orarit të mësimit.Shumë shkolla të sportit

janë duke i shfrytëzuar, dhe për rastin në fjalë më vje keq nëse ka ndodh ashtu, por kur të bëhen 10 ditë koshat do vendosen sepse ka procedura.

Urim Suka- Pyetja është për drejtorinë e shëndetësisë dhe Kryetarin: kemi marrë shqetësime nga punëtorët shëndetësor që janë të angazhuar me projektin e Karitasit për mos-pagesën e tyre për muajin mars. Kërkoj sqarime nga Drejtoria e Shëndetësisë apo Kryetari i Komunës, se pse ka ndodh një gjë e tillë dhe kur do të zgjidhet kjo qështje. Kam një pyetje që ndërlidhet me Drejtorinë e Shërbimeve Publike: në Bllacë ka shqetësime të banorëve rreth problemeve që kanë me kanalizime, shakta të bllokuar etj. Në dhjetor të vitit të kaluar është hartuar një kontratë pikërisht për furnizimin dhe sanimin e kanalizimit në fshatrat Bllacë dhe Studenqan. Për aq informatë që kam, në Bllacë ka një kohë që nuk është intervenu në sanimin e rrjetit të kanalizimit, edhe pse ju keni nënshkruar një kontratë për këtë qështje. A mund të më tregoni se ku kanë shkuar mjetet që janë parapa për furnizimin dhe sanimin e kanalizimit në Bllacë dhe Studenqan, pse nuk është intervenu në Bllacë dhe Studenqan dhe kur pritet të intervenohet për sanimin e këtyre problemeve për faktin se problemet janë të shumta.

Kryetari - është e vërtetë që ka qenë një kontakt e nënshkruar, mirëpo lënda ka shkuar në OSHP për fshatin Bllacë dhe Studenqan. Ju e dini që s'ka organ shqyrtues të prokurimit dhe deri sa nuk mirret një vendim në nivelin qendror, ne nuk mundim me marrë masa. Por nëse tash vazhdojmë me projekte të reja, në momentin e parë që na jepet shanca do të vazhdojmë me kanalizim në fshatin Bllacë. Ndërsa sa i përket pyetjes së Karitasit, ju them që nuk ka zotime, nuk ka alokime. Nëse lëshohet buxheti sot ose nesër, unë mendoj që i marrin dy pagat e fundit për Bajram dhe nëse nuk lëshohen nuk mundim me shkel ligjin.

Liridon Fandaj - kam pyetje për Kryetarin. Me datën 06.10. në emisionin "Prime time" në "Kanalin 10" ka premtur që vitin e parë të qeverisjes ka me dhanë shujta për nxënësit prej klasës së parë deri të pestën. A ka qenë veç premtim elektorale, apo kur ka me fillu?

Kryetari - në konsultim me Bordin e Prindërve nëpër shkollë, është pak problem pasi në shumë shkollë ka problem, pi gjujn edhe tamlin edhe kiflet. Jemi duke u sqaruar.

Liridon Fandaj - që dy here ndan mjete për ujësjellësin në fshatin Peqan. Ku janë tu shkuar ato mjetet pasi qytetarët nuk kanë ujë?

Kryetari - pyete kryesinë e fshatit, pyete kompaninë e Hidroregjionit, lypni marrëveshjet. Çdo gjë ne e kemi krye si Komunë. Përgjegjësia është e Hidroregjionit.

Liridon Fandaj - nëse ti i ke nda mjetet atëherë duhet me kërkua përgjegjësi prej hidroregjionit që nuk i kanë kry punimet, sepse ato mjetet janë të qytetarëve.

Kryetari - është mirë ju me bo një kërkesë zyrtare. Ne përgjegjësi kërkojmë, kontaktat janë zyrtare dhe muni me kërkua edhe ju se çka po ndodh me ujë në Peqan.

Flamur Bytyqi - ne sot jemi në muajin e pestë që nuk janë publiku thirrjet për OJQ klube sportive etj. Duke e ditë faktin që disa prej klubeve që janë tërhequr prej garave, pikërisht për këtë qështje njëra prej tyre është Samadraxha. Kam frikë që të njëjtin fat do ta përcjell edhe Studenqanin, edhe Gjinocin e Suharekën. A keni një plan kur doni mi publiku këto shpallje?

Kryetari - deri sa nuk lëshohen mjetet nuk kemi drejtë me nënshkruar asnjë kontakt, nuk kemi drejtë me bo thirrje.

Flamur Bytyqi - as në vitin 2021 nuk keni nda subvencione për klube.

Kryetari - kemi nda vitin 2021.

Elmaze Bytyqi - unë si anëtare e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për bursa, kërkoj nga Drejtoria e Arsimit që ta sjell në rishqyrtim rregulloren për ndarjen e bursave. Arsyeja është sepse nga ana ime kam vërejtur disa vështirësi të cilat kanë të bëjnë me disa nene të kësaj rregullore, e që po krijojnë huti tek anëtarët e komisionit dhe pabarazi tek aplikuesit. Unë si përfaqësuese e LDK-së jam munduar maksimalisht ta respektoj këtë rregullore dhe me përgjegjësi të plotë e them se, edhe nëse ka shpëtuar ndojnë gabim eventuale, s'ka qenë fare e qëllimshme sepse nuk kam pas asnjë tendencë ndaj askujt. Njëherit kërkoj nga Kuvendi Komunal që të na mudësohet ta kemi një zyre të gjithë anëtarët e komisioneve të ndryshme. Unë si anëtare do ti jap dy variante për plotësim ndryshim. Varianti i parë është që të ndahen bursa për nxënësit dhe studentët të skemave sociale dhe për nxënësit e studentët të dalluar. Poashtu edhe pa kritere të kenë mundësi përfitimi nxënësit e studentët që nuk e kanë asnjërin prind ose i kanë me aftësi të kufizuara. Varianti i dytë është plotësim-ndryshimi i rregullores aktuale. Këtu kemi fëmijët pa njërin prind, vlerësohen me 10 pikë, fëmijët me njërin prind me nevojë të veqanta dhe vet fëmija me nevojë të veqanta vlerësohen 15 pikë. Kjo po na qon në lajthitje, sepse në shumicën e rasteve ne kemi dy prind me nevojë të veqanta ose njëri prind me nevojë të veqanta. Rrallë ndodh të jenë edhe prindi, edhe një edhe

prindi,edhe nxënësi me nevoja të veqnta.Pika tjetër ku duhet të plotësohet është fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së vlerësohen vetëm me 10 pikë.Kërkoj që femijët e invalidëve të luftës të vlerësohen me 15 pikë sepse me 8 pikë janë veteranët, kur e dim që ata mund ta bëjnë edhe një punë shtesë.

Kryesuesi - e marrë shqetësimin dhe Drejtorja e Arsimit do ta ketë parasysh kërkesë tuaj.

Selman Kolgeci - kam dy pyetje për drejtorin e Urbanizmit por meqenëse nuk është këtu kërkoj përgjigje nga Kryetari.Në qytetin tonë së paku 4 nje kryesore të komunikacionit janë të mbuluara me kamera të sigurisë.Kjo në fakt është në shërbim dhe të ofrimit të sigurisë në qytet.Por a jeni në dijeni se vrojtimi i qytetarëve përmes kamerave të tilla pa paralajmërim paraprak është në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe udhëzimet e nxjerrura nga agjencia shtetërore për mbrojtjen e të dhënave personale.Kërkoj që kjo shkelje të mos vazhdojë të mbetet e tillë por të plotësohet me sinjalistikë përkatëse.gjithëashtu më lejoni të ju njoftoj se këtë intervenim mund ta bëni nga dy burime,ndryshe them nga dy kontrata që Komuna e Suharekës i ka lidhur kundërligjshëm me dy operator ekonomikë.Kërkoj sqarime nga Kryetari të na jap sqarime lidhur me vendosjen e numrave nëpër shtëpi.A ka pasur nisma për implementimin e këtij projekti të rëndësishëm me qëllim të funksionimit të mirë të postës e më shumë rreth përditësimit të Haratave Digjitale,dhe pse ky projekt ka ngecur.

Driton Maliqaj - projekti për vendosjen e kamerave të sigurisë ka qenë projekt i Drejtorisë së Administratës,dhe me të drejtë Selmani e kërkon diçka që është obligim ligjor të vendoset sinjalizimi për kamerat që janë të vendosuar në haosira publike.Unë me kompetencë të plotë e them që,të gjitha kamerat ku kanë qenë të vendosura kanë pas sinjalizimin në formë të stikersit në shtylla.Ato janë vendos në vitin 2018-2019 dhe ka mundësi që deri tash ose janë tërheq,ose janë dëmtu gjatë punimeve.

Selman Kolgeci - duhet mu vendos shenjat e komunikacionit në katër hyrjet e qytetit,me tregu që qyteti monitorohet nga kamerat,jo stikera.A do ti vendosni këto shenja ?

Kryetari - unë besoj që kanë mu vendos shumë shpejt.Ne mundemi me vendos kamera të sigurisë edhe te shetitoret,sepse për çdo vit kemi shkatërrime,mirëpo ajo është privatësi dhe skemi pas të drejt .Unë ka me dal me një vendim shumë shpejt,ka mi njoftu qytetarët.Kanë fillu largimi i deponive ilegale dhe kem plan me vendos kamera të fshehta,po flas për deponi ilegale.

Sanie Kuçi Rexhepaj - sa i përket sistemit të unifikuar të adresave,ne si drejtori kemi mbajtur disa takime me agjensionin kadastral të cilët kanë premtu që kanë me përkrah komunën e Suharekës në kompletimin e sistemit të adresave.Për vitin 2020 patën planifikuar me i nda 5 million euro për të gjitha komunat për me përfundu këtë proces para regjistrimit të popullsisë,mirëpo situata pandemike ka ndikuar te agjensini kadastral të cilët e kanë shty këtë projekt ma tutje.Shpresoj që këtë vit ndoshta kanë me implementu.

Selamn Kolgeci - po nëse nuk e përkrah agjensia kadastrale këtë projekt,a ka me vazhdu me mbet akoma pa numra shtëpitë tona ?

Sanie Kuçi Rexhepaj - besoj që ka me përkrah sepse e ka kusht para fillimit të regjistrimit të popullsisë.

Selman Kolgeci - nuk na pengon ajo nëse ne kishim pas buxhet dhe ishim kan vigjilent me investu dhe me ju nimu atyne.A ka pas nisma për këtë ?

Sanie Kuçi Rexhepaj - nisma ka pas,por përderisa ka pas premtim që ata kanë me na financu,pse mi hargju na paret tona kur i kemi pas paret e atyre.

Festë Kabashi - kam pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike.Pse nuk funksionon asnjëherë ndriçimi publik te ndërtesat e Ballkanit ?Banoret ballafaqohen me qentë endacak,edhe pse kjo është problematikë edhe në lagje e qytete tjera.

Enver Shabani - ndriçimi publik te Banesat e Ballkanit si rrjet është pak ma i vjetër krahasuar me rrjetet e reja.Ne jemi duku u mundu Aty kemi intervenu disa herë,spse ka pas probleme kohë pas kohe.

Festë Kabashi - sa i përket komisionit të bursave për anëtarët që janë këtu,kam një pyetje.A ka pas raste kur nxënësit ose studentët i kanë marrë pikët e meritume,por për shkak të numrit të kufizuar nuk kanë arrit me marrë bursë ?

Elmaze Bytyqi- nuk ka pas nxënës që i kanë bo pikët dhe që nuk e kanë marrë,por ka pas nxënës që i kanë pas prind të bizneseve dhe nuk i ka taku.

Qëndrim Elshani - Pse është zhvendos ilegalisht stacioni i autobuave në Shirokë në një vend tjetër ?

Kryetari - është i vendosun.

Liridon Fandaj - është i vendosun por nuk është legalisht,jo në atë vend.

Alban Berisha - faleminderit për ftesën për stadium,por a me marr naj paket me veti me kqyr lojën.

Kryetari - ke të drejtë.Seancën e radhës keni me pas ni kërkesë për një stadium të ri bashkë, Federata e Futbollit,Ministria e Kulturës dhe Komuna.

Alban Berisha - me bindje të plotë i uroj Ballkanit prej tash,poashtu po shpresoj edhe për Yllin.Normal që kam qef ne mos me shku në Prishtinë mi lujt lojrat kualifikuese, mi aps në Suharekë por ajo është e pamundur.Por të paktën ta kemi një stadium edhe vizualisht të mirë dhe një stadium ku mujna me marr familjen me kqyr lojën.Ne dim mirë se si shkon puna e subvencioneve,thjesht e jina është vetëm obligim infrastrukturor sa të mujm.

Kryetari - a kishe investu ti sikur të ishe Kryetar i Komunës këtë stadion ku jemi sot.

Alban Berisha - jo, unë kam thanë gjithmonë që duhet me kqyr alternativa me bo ni stadium tjetër,sepse ky stadion nuk i plotëson kushtet.Mas stadiumit nuk duhet me lan anash as palestrën,sepe dita ditës kemi tkurrje shikueshmërie nëpër palestra.

Kryetari - te salla sportive janë të ndane dikun 50 mijë euro,për shkak se duhet mu bo ni aneks sepse nuk i plotëson kushtet për gara.Besoj që këtë vit rregullohet.

Sheqerije Zyrapi - kam kërkesë për Asamble,me ndërru orarin e mbajtjes së seancës,sepse kemi shumë mësues këtu e po na bje me hub mësimin,edhe pse lejohet me ligj.

Liridon Fandaj - mbledhjen e kaluar ka qenë shefi i stacionit të autobusave dhe më ka thënë që ki drejt mi kërku pasqyrat financiare.Unë i kam kërku por prap të njejtat mi ka dhënëTjetër shqetësim në stacionin e autobusave është se ka shumë lokale dhe janë vetëm tre kontrata që mi ka dëshmu stacioni i autobusave.Kjo është shqetësuese se ky Kuvend e ka emru një bord që nuk ka përgjegjësi.Do ti ngris këto edhe në organet tjera.

Shefket Kolgeci - e di që kjo Asamble e kena marrë një vendim për me ndërru një stadion.Ia kemi dhënë edhe firmës Cima me sa e di.Kërkoj nga Kryetari se çka u bo me atë punë,a do të realizohet ?

Kryetari - është e vërtetë,ka kalu në Asamblenë Komunale.Kontrata nuk u nënshkru asnjëherë,për arsye se kanë dal do letra,dhe aty ku ka konteste, Komuna e ndërpren çdo gjë.Kontrata nuk është valide edhe pse ka dal nga Asamblea.Nuk u nënshkru dhe ajo e ka kalu afatshmërinë.

Takim i përfundoi : 12 :30

Procesmbajtësja :
Dafina Haziraj